



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME NR.1 E PUNËTORËVE TË QYTETIT
DREJTORIA PLANIFIKIMEVE DHE MENAXHIMIT

Nr. _____ prot.
2019

Tiranë, më ____ . ____ .

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: **“GAJD Company” shpk me Nipt: K79631501Q, me Adresë: “Rruga Fushë-Tepelënë, Zonë kadastrale Nr.3574, Nr. Pasurie 8/22, Gjirokastrër, Tepelenë, me Administrator Z. Alfred Qëndro.**

- 1.Procedura e prokurimit: **“Procedurë e hapur”**
- 2.Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-21744-05-13-2019**
- 3.Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Pjesë këmbimi, goma, bateri, filtra”**
4. Fondi Limit: **12 400 000** (dymbëdhjetë milion e katërqind mijë) **lekë pa tvsh**
- 5.Burimi i të ardhurave: **Bashkia Tiranë.**
- 6.Kohëzgjatja e kontratës: **15 ditë nga data e lidhjes së kontratës**
7. Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët**
8. Data e zhvillimit të procedurës: **06.06.2019 ora 11:00**

Njoftojme se kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomik si më poshtë:

Ofertat e paraqitur nga:

1. **Operatori ekonomik “C.A.A.” sh.p.k me Nipt: K71520008O me cmim total të ofertës:**

Adresa: Rruga “5 Maji”, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

- **12 325 500** (dymbëdhjetë milion e treqind e njëzet e pesë mijë e pesëqind) **lekë pa tvsh** dhe
- **14 790 600** (katërbëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë mijë e gjashtëqind) **lekë me tvsh.**

Shqyrtohet oferta e paraqitur nga ofertuesi “C.A.A” shpk me Nipti K71520008O nga ku rezulton se:

Tek kriteret e veçanta të kualifikimit pika 1.b: OE C.A.A sh.p.k nuk e plotëson pikën (b), pasi deklarata e paraqitjes së ofertës së pavarur nuk është e rregullt, pra e formuluar si duhet.

OE C.A.A sh.p.k nuk e plotëson pikën 2.2 tek kriteret e veçanta, specifikisht tek kapaciteti ekonomik dhe financiar, OE C.A.A sh.p.k nuk ka paraqitur dokument i cili përmbush nënpikën (b) të pikës 2.2, pra i mungon dokumenti për xhiron vjetore, gjithashtu OE C.A.A sh.p.k nuk plotëson pikën (a), pasi nuk i ka bilancet e shoqëruara nga Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të liçensuar.

OE C.A.A sh.p.k nuk plotëson pikën 3, nënpika (a) tek kapaciteti teknik pasi nuk ka paraqitur një dokument i cili vërteton shlyerjen e taksave vendore për vitin 2019, në njësitë ku OE operon.

OE C.A.A sh.p.k nuk plotëson pikën c tek Kapaciteti Teknik, pasi i mungojnë çertifikatat ISO 14001:2015, si dhe ISO/TS 16949:2009, si dhe PAS 99:2012. Gjithashtu OE C.A.A sh.p.k nuk plotëson pikat 1; 2 dhe 3 të pikës (c) kapaciteti teknik pasi malli goma nuk rezulton i çertifikuar sipas standarteve ISO 9001:2015, ISO/TC 16949:2016. Gjithashtu mungon çertifikimi për mallin bateri sipas standarteve ISO 9001:2015. Si dhe çertifikimi për mallin filtra sipas standartit ISO 9001:2015.

OE C.A.A sh.p.k nuk plotëson pikën (e) tek kapaciteti teknik pasi mungon Autorizimi i Prodhuarit ose Distributorit Zyrtar për mallrat (goma, filtra, bateri).

OE C.A.A sh.p.k nuk plotëson pikën (f) tek kapaciteti teknik pasi nuk ka paraqitur një dokument që vërteton se OE është i pajisur me pikë shërbimi gomisteri, në pronësi apo qera, për të kryer shërbimin e zëvendësimit të gomave dhe baterive.

OE C.A.A sh.p.k nuk e plotëson pikën (g) tek kapaciteti teknik pasi nuk ka paraqitur çertifikatë origjine për mallin.

OE C.A.A sh.p.k nuk plotëson pikën (h) tek kapaciteti teknik pasi nuk ka paraqitur një dokument i cili vërteton se gomat janë prodhim i brënda 1 viti nga data e zhvillimit të tenderit.

OE C.A.A sh.p.k nuk plotëson pikën (i) tek kapaciteti teknik pasi nuk është

paraqitur në ditën e hapjes së ofertave për të paraqitur artikujt (mostrat) e kërkuara nga AK.

2. Operatori ekonomik “GAJD Company” sh.p.k me Nipt: K79631501Q me cmim total të ofertës:

- **12 275 500** (dymbëdhjetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind) **lekë pa tvsh** dhe
- **14 730 600** (katërbëdhjetë milion e shtatëqind e tridhjetë mijë e gjashtëqind) **lekë me tvsh.**

Shqyrtohet oferta e paraqitur nga ofertuesi “GAJD Company” shpk nga ku rezulton se:

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim
- I plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST
- Përsa i përket llogaritjes së vlerës së ofertës nuk rezulton anomalisht e ulët.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me nenin 53 të Ligjit Nr. 9643 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe dokumentave të tenderit të miratuar, u konstatua se oferta e Shoqërisë “GAJD Company” shpk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e shpallur si ofertë të vlefshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit , Tiranë për sigurimin dhe nënshkrimin e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **30 ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Klasifikimi u bë me datë **07.06.2019** në sistemin elektronik të APP-së

Ankesa: Nuk Ka

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Arlinda Binjaku